



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Grupi i Deputetëve Miqtë e Fëmijëve*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 20.02.2019, ora 12:00

**Rendi i ditës:**

Tryezë pune mes Komitetit për të miturit në konflikt me ligjin, Komitetit për marrëdhëniet me OSHC-të dhe përfaqësues të organizatave, lidhur me sigurinë dhe incidentet me të cilat fëmijet janë ndeshur në Shqipëri gjatë vitit 2018.

**Marrin pjesë:**

Vasilika Hysi, Milva Ekonomi, Elena Xhina, Klotilda Bushka.

Altin Hazizaj – CRCA;

Linda Pino – Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri;

Melaim Degnushaj – Grupimi “Të gjithë jemi të ndryshëm, por të barabartë”.

## HAPET MBLEDHJA

**Vasilika Hysi** – Përshëndetje!

Në radhë të parë doja të bëja një falënderim për Altinin, Lindën dhe Melaimin!

Unë jam njohur me raportin e parë të CRCA-së për sigurinë në internet të fëmijëve dhe të të rinjve në Shqipëri, “Internet i sigurt”. Njëkohësisht, javën e kaluar kam pasur një takim me Altinin, me të cilin kemi folur konkretisht për disa shqetësime që ai ka adresuar pas ngjarjes së ndodhur në Kavajë, si dhe një diskutim të detajuar me kolegën Gjermani me të cilën ju keni pasur një takim në Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës.

Sot, sikurse u dakordësuam edhe me Altinin, janë të ftuar deputetë të nënkomisionit që merret me shoqërinë civile dhe organizata që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe anëtarë të nënkomisionit që merret me fëmijët që janë në kontakt me drejtësinë penale, ku për fatin tonë të mirë ne kemi një Kod të Drejtësisë Penale, por për fatin tonë jo të mirë kemi pasur disa ngjarje që na kanë vënë përballë në drejtësinë penale të miturin si edhe autor, por edhe të miturin si viktimë.

Altini ka dërguar një *e-mail* ku ka adresuar disa shqetësime për Aleancën e Grave Deputete, ku një pjesë e çështjeve që ai ka adresuar që lidhen me legjislacionin, me politikën, me fushatat e informimit dhe të sensibilizimit, me mbështetjen e shërbimeve për viktimat, forcimin e sistemit të raportimit e të tjerë kanë të bëjnë edhe me Aleancën e të Drejtave të Fëmijëve, kanë të bëjnë edhe me komisionet parlamentare, por edhe me angazhimin e çdo deputeti si përfaqësues i një zone ku ai është zgjedhur, ndërkohë që për një sërë nismash ka pasur diskutime dhe debate.

Altin, nëse më lejoni shkurtimisht t’i përmend, pasi ju keni ngritur një shqetësim, të cilin e shoh edhe te raporti “Hije” që keni përgatitur lidhur me ciklin e tretë të Raportit Universal Periodik lidhur me ndryshimet në Kodin Penal për dhunën seksuale. Në fakt, ka pasur një korrespondencë midis disa deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë, përfshirë mua dhe CRCA-në, si dhe kemi pasur një korrespondencë përgjigjesh dhe adresimesh për të cilën doja t’ju vija në dijeni, pasi këtë shqetësim ia kam adresuar edhe ministres së Drejtësisë zyrtarisht vitin e kaluar dhe kam marrë një përgjigje zyrtare. Në këtë përgjigje thuhej se të gjitha paketat e propozimeve për ndryshime në Kodin Penal do të jenë objekt i shqyrtimit së bashku, pasi ka disa nisma të depozituara, sepse nuk është vetëm nisma për rastet e dhunës seksuale.

Pra, kemi detyrime në kuadër të GREVIO-s, të MANIVAL-it, si dhe ndërhyrjet kaq të shpeshta që i janë bërë Kodit Penal dhe përgjigja pa u konsultuar gjerësisht me të gjithë ekspertët dhe institucionet ka bërë që procesi të mos jetë ai që duhet. Ju e dini që ne te dispozita për shfrytëzimin e fëmijëve, neni 124, si dhe për dhunën në familje kemi amenduar 2-3 vjet rresht, propozimet 12, 13, 17. Pra, duke qenë propozime të shoqërisë civile i kemi marrë dhe i kemi depozituar si nisma propozimet e tyre, por më vonë ka rezultuar nga vetë autoritetet se mekanizmat monitorues të konventës duhet të rishihen dhe të riformulohen.

Për shembull, EKRI ka bërë rekomandime për amendamentet që u bënë me propozimin e Avokatit të Popullit, për gjuhën e urrejtjes dhe rrjetet kompjuterike dhe na i kanë lënë si detyrë që t'i shohim të gjitha dispozitat. Kjo do të thotë që shpeshherë ndërhyrjet që bëhen për shkak të një sugjerimi, të një projekti apo të një grupi interesi kanë rezultuar që duhet të jenë më të menduara, më të studiuara dhe më të konsultuara, sidomos nga pikëpamja e teknikës legjislative.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk po i futem thelbit, jam shumë dakord që duhen adresuar, por duke u bërë nga Kuvendi dhe kur nuk janë të gjitha kapacitetet e kodifikimit, ndërkohë që mund të afektohen shumë ligje të tjera ku një komision apo një deputet nuk janë në dijeni, kjo gjë na ka dëmtuar.

Sa i takon ligjit “Për komunikimet elektronike”, pasi ju thoni se ka nevojë për disa shtesa të vogla që bëjnë të mundur mbrojtjen nga vajzat dhe djemtë, pa e ditur që ju do ta kishit sugjeruar këtë unë i jam drejtuar AKEP-it dhe AMA-s në cilësinë e kryetares së Nënkomisionit të Drejtave të Njeriut, por shqetësimi ynë, në fakt, lidhet në përgjithësi me gjuhën e urrejtjes dhe komunikimet jo vetëm për këtë çështje.

Ligji për komunikimet elektronike prej kohësh është në një konsultim publik nga qeveria për t'u ndryshuar dhe ndoshta ky do të ishte një moment shumë i mirë për ta adresuar edhe këtë shqetësim. Unë sot kisha ftuar edhe përfaqësuesen e ministres së Shtetit për lidhjet me Parlamentin, pasi Elisa ka qenë pjesë e këtij nënkomiteti, por nuk e di pse nuk ka ardhur...

*(Diskutime pa mikrofon)*

... është edhe deputete. Megjithatë, mbledhja është duke u regjistruar dhe shqetësimin që kemi do ta ndajmë me të.

Lidhur me regjistrin kombëtar për krimet seksuale, një kërkesë shumë e vjetër e CRCA-së, ka pasur një debat, besoj se Altini e mban mend, kanë qenë të pranishëm shumë deputetët,

përfshirë edhe unë, janë ndarë mendimet pro dhe kundër, ju besoj e dini. Gjithashtu, ka pasur mendime pro dhe kundër edhe midis ekspertëve kombëtare sa i takon këtij regjistri.

Unë për momentin nuk mund të flas, ndoshta kolegët dhe këshilltarët që janë të pranishëm këtu mund ta thonë mendimin e tyre, por mendoj se është e nevojshme të zhvillohet më tej. Altin, besoj se e mban mend që kemi pasur një debat lidhur me të dhënat personale, ku disa vende si SHBA e kanë, ndërsa disa vende të Bashkimit Europian nuk e kanë të hapur. Kjo është një çështje shumë sensitive për të cilën unë do të kërkoja një konsultim shumë më të gjerë edhe me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me Komisionerin për Parandalimin e Diskriminimit, me Ministrinë e Drejtësisë, me Ministrinë e Brendshme, me Prokurorinë e të tjerë, por nga ana tjetër do të doja të ndaja me ju një lajm shumë të mirë. Sot, në Komisionin e Ligjeve kemi miratuar dy kalendar pune.

E para, është kalendari i punës i Komisionit të Ligjeve, i Nënkomisionit të të Drejtave të Njeriut, si dhe i disa nënkomisioneve si ai për qeverisjen vendore dhe administratën publike, por kemi përfshirë edhe nënkomisionet e tjera lidhur me të drejtat e njeriut në kuadër të integritetit evropian. Është një kalendar shumë i detajuar, i cili do të bëhet publik besoj menjëherë, sepse sapo është miratuar dhe do ta gjeni në faqen e Kuvendit.

E dyta, është kalendari që lidhet me raportimet e institucioneve të pavarura. Në këtë kuadër raportimet e tyre do të mbyllen shumë shpejt në krahasim me vitet e tjera dhe kështu do të kemi mundësi t'i adresojmë këto shqetësime dhe të marrim një opinion qoftë nga Avokati i Popullit, qoftë nga Komisioneri për Parandalimin e Diskriminimit apo Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pse jo edhe nga institucionet përkatëse siç janë Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Drejtësisë.

Altin, të marrim në fillim 3 çështjet që keni adresuar dhe më pas kalojmë te çështjet e tjera.

Faleminderit!

**Altin Hazizaj** – E nderuar zonja Hysi, ju falënderoj ju dhe gjithë kolegët që janë të pranishëm!

Në fakt, unë shpresoja, por meqë njoftimi u bë sot për nesër ndoshta nuk ishte e mundur pasja e një numri më të madh kolegësh. Ne jemi organizata që ka eksperiencë në fusha të ndryshme si ajo e arsimit dhe fusha të tjera, por ne merremi edhe me çështjen e trafikimit,

shfrytëzimit dhe të dhunës dhe pa diskutim CRCA-ja që është një organizatë e specializuar në mënyrë specifike për të drejtat dhe liritë e fëmijëve dhe të rinjve.

Sa u takon aspekteve legislative, ju falënderoj për parantezën dhe paraqitjen e jashtëzakonshme!

Unë do të trajtoj 2-3 momente kryesore, të cilat mendoj se ia vlejnë siç është çështja e ndryshimeve në Kodin Penal, meqenëse ne si zyrë jemi përfshirë që nga viti 2002 dhe në vijim, kjo falë edhe ekspertizës që ka organizata. Propozimet, të paktën ato që kanë ardhur nga CRCA-ja, në Shqipëri nuk janë miratuar asnjëherë *mot a mot* siç janë dërguar nga ana jonë kjo për arsye, sepse ato duhet të kalojnë një proces diskutimi ndërmjet deputetëve, juristëve të komisioneve dhe produkti final nuk është ai që ne kemi propozuar.

Për çështjen që ka të bëjë me shitjen e fëmijëve, pavarësisht se ne kemi propozuar atë që do ta konsideroja definicioni ose përkufizimi ndërkombëtar i shitjes së fëmijëve, parlamenti kaloi një nen më të përmbledhur.

Sa i përket pornografisë së fëmijëve, ne kemi propozuar që neni përkatës të ishte ai i rekomanduar në nivel ndërkombëtar, por përsëri, edhe në momentin që flasim, pavarësisht se u rregullua si nen, ai nuk përmban të gjithë format e pornografisë së fëmijëve që ndodhin në internet dhe jetën e përditshme. Një shqetësim për këtë çështje janë imazhet e prodhuara të fëmijëve, pra jo imazhi i vërtetë, por i dizenuar, që është në formën e një kartoni, ose një formë dixhitale e avancuar ku personi duket si fëmijë, por nuk është fëmijë real. Legjislacioni ndërkombëtar rekomandon që edhe imazhe të tilla, pavarësisht se janë krijuar në mënyrë dixhitale, të përfshihen në atë që konsiderohet pornografi e fëmijëve, sepse thuhet se i gjithë Bashkimi Europian i ka të ndaluara me ligj. Pavarësisht se janë forma të dixhitalizuara, shqetësimi ynë është se Kodi Penal nuk i përgjigjet, për më tepër ka një rekomandim nga Bashkimi Europian që të gjitha legjislacionet e të gjitha vendeve të Europës, që aspirojnë të jenë pjesë e Bashkimit Europian, të përputhen sa i përket çështjeve të dhunës seksuale, formave të pornografisë, imazheve e të tjera. Ne kërkojmë që ligji shqiptar të jetë në përputhje me aktet e *acquis*.

Sa i përket gjuhës së urrejtjes, propozimi ynë, i bërë së bashku me ambasadën Pink, Avokatin e Popullit, dhe CRCA, kërkon që në gjuhën e urrejtjes të përfshihen edhe personat që kanë një identitet gjinor të ndryshëm. Në fakt, propozimi ynë nuk kaloi. Sidoqoftë unë besoj se

procesi i konsultimeve, procesi i diskutimeve është me vlerë dhe gjithmonë them se jemi në kohë që t'i kalojmë propozimet.

Sa i përket qëndrimit të ministrisë së Drejtësisë, nuk është një qëndrim zyrtar, por po e marr të mirëqenë diskutimin që ju keni pasur.

Sa i përket Kodit Penal, nëse ne do të rrimë dhe presim, krimet do të vazhdojnë të ndodhin ndaj fëmijëve dhe institucioni që përballet me to nuk jemi ne, sepse ne përballemi shumë vonë, institucioni që përballet është policia, e cila thotë në komunikimet e shpeshta që ne kemi me të, se nuk e kanë ligjin ose nenin përkatës, pra nuk kanë bazë ligjore për ta mbrojtur fëmijën nga dhuna seksuale dhe ngacmimet seksuale *online*. Ndryshime të vogla, të cilat nuk janë të qenësishme, por që kërkojnë diskutime me të gjithë aktorët, që janë pjesë e sistemit të drejtësisë, duhet të rekomandohen të kalojnë në Kodin Penal. Për këtë ne mund të bëjmë një diskutim të gjerë. Propozimet që ne kemi bërë janë propozime të konsultuara, të cilat i kemi prezantuar në dy workchop-e me prokurorinë, policinë, zyrtarët nga të gjitha ministrinë, duke përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë. Konsultimi, është bërë, rekomandimet me shkrim nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, policisë janë dërguar. Ne po përdorim për përkufizime ato që rekomandohen në direktivën e Bashkimit Europian. Sa i përket ligjit për .... jemi në kohë. Në shqyrtimet dhe propozimet që AMA dhe AKEP-i kanë bërë, nuk janë përfshirë çështjet e fëmijëve. Ne kemi marrë pjesë në workchop-in e dytë konsultues ku kemi adresuar disa rekomandime të përgjithshme, sepse deshëm, në fakt, të bënim një diskutim më personal me AKEP-in për ta shikuar si një kontribut të përbashkët çështjen e ndryshimeve. Jemi takuar javën e kaluar me përfaqësuesit AKEP-it, kemi rënë në dakordësi me ta për propozimet që ne si zyrë ligjore (CRCA), do të bëjmë. Nëse do të vijë ato do të jenë pjesë e paketës së mbrojtjes nga shpifja online, ose disa rregullime ligjore.

Meraku që ne kemi është se, meqenëse ndryshimet propozuara në dy ligje kanë marrë kundërshtinë e një pjese të mirë të organeve të medieve dhe të OSBE-së, si jurist i vjetër, në fakt, unë kam një pikëpyetje: nëse për një moment të caktuar do të duhet të merret një vendim politik. Pra, që të mos na bien edhe propozimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, jemi duke parë nëse do t'i paraqesim si pjesë të tyre, ose do t'i paraqesim si propozime të veçanta të një grupi të ofj-ve, ose si CRCA.

Sa i përket regjistrimit të krimeve seksuale, që është një kërkesë shumë e vjetër që nga viti 2008, ne kemi arritur në konkluzionin që do të ndiqet modeli francez, dhe modeli britanik, të

cilin ne e kemi marrë për bazë. Modeli francez dhe britanik janë njëloj tashmë. Pas ankimimeve që ka pasur në Shoqatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, modeli është i tillë që policia ka të drejtë të zotërojë emrat dhe mbiemrat dhe identitetin e personave, por askush tjetër. Nga ana tjetër ajo që ne duam, që e kanë të gjitha organizatat, që merren me fëmijët, është se në momentin që unë punësoj një person më duhet një certifikatë që ai person nuk është i regjistruar në këtë regjistër. Kuptohet që edhe ndaj atij subjekti që merr informacionin, zbatohet ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, sepse mua nuk më jep ligji të drejtë që të shpërndaj informacion sa i përket statuseve që mund të ketë një person.

**Vasilika Hysi** - Unë do të bëj një rezyme lidhur me ndryshimet në Kodin Penal. Meqenëse ju keni edhe opinionin e Prokurorisë së Përgjithshme, edhe të Ministrisë së Brendshme, unë do të informoj Kryetarin e Kuvendit, pasi ne do të kemi një mbledhje të radhës së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, ku do të miratojmë raportin vjetor të veprimtarisë së grupit. Kur t’i kalojë seancës plenare do të keni mundësi ta ndiqni diskutimin. Grupi i deputetëve “Miqve e fëmijëve”, ka deputetë nga të gjitha grupet parlamentare dhe nga të gjitha komisionet, kështu që kemi nevojë për të pasur opinione të ndryshme.

Së dyti, ne mund të thërrasim ministren e Drejtësisë, ndërkohë edhe përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe Prokuroria e Përgjithshme për të bërë këtë diskutim, sikurse e bëmë edhe me rastin e ndryshimeve në ligjin për gjendjen civile për regjistrimin e fëmijëve.

Së treti, lidhur me komunikimet elektronike, kjo mund të jetë pjesë në diskutimin e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, por mund të ftohet edhe Komisioni i Medies. Është e vërtetë që paketa antishpifje ka pasur kundërshtime nga gazetarët, por nga ana tjetër unë do të doja të theksoja se ka një rekomandim, i cili është rekomandimi i 15 i Komisionit Evropian “Kundër Racizmit dhe Intolerancës”, i cilin u kërkon shteteve të marrin masa civile, penale, administrative dhe media të vetërregullohet, por nuk i përjashton masat penale, civile administrative lidhur me stopimin e gjuhës së urrejtjes dhe ndëshkimin, nëse pasi janë përdorur mekanizmat vetërregullues të medies, nuk janë marrë masat për të riparuar këtë gjë. Për ta ditur rekomandimi adreson të gjitha format e gjuhës së urrejtjes edhe ndaj LGBT-ve, edhe ndaj minoriteteve, ndaj etnive, gjuhës, e të tjera, por fëmijët nuk përjashtohen, sepse fëmijët që mund të diskriminohen ose mund të jenë viktima, nuk janë vetëm të maxhorancës, por i përkasin edhe opozitës, edhe pakicave, edhe grupeve të ndryshme që unë përmenda. Duke rregulluar

statusin për kategoritë në pakicë në një shoqëri, që janë me orientim të ndryshëm, ose pakica kombëtare etnike për shkak të gjuhës, gjinisë e të tjerë, ne kemi rregulluar problemin në tërësi.

Në këtë kuadër, do të doja të bëja një takim me zotin Zela dhe me Drejtorin e AMA-s dhe mund ta kishim si çështje të dytë të rendit të ditës në Grupin e Deputetëve Miqtë e Fëmijëve. Për këtë, Altin, do të doja të kishim një informacion të përmbledhur për t'ia vënë në dispozicion Kryetarit të Kuvendit se çfarë është bërë dhe ku synojnë nismat, sikurse vepruam për rastin e ndryshimeve të ligjit të gjendjes civile. Në rast se nuk ka mundësi që të bëhet nëpërmjet projektit të qeverisë, mund të përdoret nisma ligjore e deputetëve, ose e grupit të deputetëve, por do të preferoja që ndryshimet në ligjin e komunikimeve elektronike dhe në ligjin e medias audiovizive të bëhen së bashku me të gjitha ndryshimet që kërkon edhe EKRI dhe GREVIO në kuadër të paketës anti-shpifje, sepse jemi në një moment që po ndërhyjmë shpesh në legjislacion, ndërkohë që këto i shoh të ndërvarura me njëra – tjetrën.

Më vjen mirë që e sqaruat çështjen e regjistrimit, sepse, kur kemi folur në shumë tryeza kam qenë e pranishme, ideja ka qenë për një regjistër shumë më të gjerë, por, në rast se regjistrin do ta ketë vetëm policia, mendoj të kemi një takim të radhës me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, me një grup më të madh deputetësh, jo vetëm nga Grupi i Deputetëve Miqtë e Fëmijëve, por edhe deputetë të Komisionit të Ligjeve, të Komisionit të Sigurisë dhe Komisionit të Medias. Nuk është e thënë të jetë një seancë e madhe dëgjimore, sepse ndonjëherë ato kthehen në *show* dhe na dëmtojnë, por një tryezë konkrete dhe më pas të shikojmë se si do të hidhen hapat.

Unë kam një pyetje: bërja e Regjistrimit Kombëtar kërkon ndryshime në ligj, apo thjesht mund të rregullohet me një akt nënligjor nga Policia e Shtetit?

**Altin Hazizaj** - Në të gjitha vendet, edhe në Amerikë, është zgjidhur me ligj të veçantë procedural, sepse ka të bëjë me procedurat se cili mban të dhënat dhe, nga ana tjetër, vendos disa detyrime për personat që janë të regjistruar në regjistër. Personi që është i regjistruar në regjistër nuk mundet të lëvizë kaq lirisht pa njoftuar policinë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk i kufizohet e drejta për të lëvizur, është e drejta e tij/saj, por ka detyrimin për të raportuar. Detyrimi për të raportuar do të thotë se, në qoftë se unë planifikoj që nesër të udhëtoj në Durrës, jam i detyruar të njoftoj policinë, pasi ekziston gjithmonë rreziku që një person që ka tendencën dhe që është i deklaruar...



Policia duhet të jetë në dijeni, sepse...

*(Diskutim pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Deputetja Milva Ekonomi është personi që ndjek zbatimin e objektivave të “Axeve 2030” të zhvillimit të qëndrueshëm të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për Monitorimin e Zbatimit të SDG-ve, por njëkohësisht është edhe nënkryetarja e komisionit. Tashmë jemi në momentin kur Milva do të duhet të drejtojë diskutimin: Milva, po bëhet një diskutim për të pasur një takim me AMA-n dhe AKEP-in lidhur me një shqetësim që kanë ngritur CRCA-ja dhe organizatat e tjera për format e abuzimit *on line*, pasi deri më sot nuk ka rregullim ligjor, thekson Altini, edhe policia mund të ndalojë dikë, por nuk e procedon dot, sepse nuk ka një rregullim ligjor për këtë.

Ndërkohë, meqenëse ligjet me 3/5-t kërkojnë një maxhorancë shumë të madhe, dhe ligji për komunikimet elektronike dhe mjetet audiovizive, në kuadër të paketës antishpifje, është në proces rishikimi, të bëhet një konsultim paraprak me ta, për të përfshirë edhe këtë çështje që të mos ndërhyhet disa herë në ligj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të sugjeroja që për të përditësuar ligjet ne mund të bëjmë edhe një takim të radhës të Grupit të Deputetëve Miqtë e Fëmijëve, se Kryetari do të prezantojë raportin vjetor para se t'i shkojë seancës plenare dhe prezantimi i paketës së ndryshimeve në Kodin Penal mund të jetë një pikë e dytë e rendit të ditës, por edhe propozimet që ka CRCA-ja dhe organizatat e tjera lidhur me këtë çështje. Si mund ta kalojmë?

Meqenëse këto ligje nuk kërkojnë shumicë të cilësuar, nuk do të pëlqejë të ndërhyjë në legjisllacionin hera-herës në qoftë se do të jenë bashkë.

Çështja e dytë, kjo është fiks koha tani, Milva, janë politikat. Altini ka ngritur tri shqetësime: e para, kërkon një plan kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe këtë e kërkon si një nevojë urgjente që duhet të vijë nga Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit, së bashku me shoqërinë civile dhe deputetët; e dyta, Kodin e Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve; e treta, protokollin e rastit sipas çdo profesioni, kjo besoj i takon Komisionit të Shëndetësisë.

Do të doja pak më shumë informacion, Altin. Linda, kjo nuk është thjesht vetëm për Grupin e Deputetëve Miqtë e Fëmijëve, pavarësisht se ne do të përfshihemi, por prek shumë komisione.

**Milva Ekonomi** – Është e vërtetë që prek shumë komisione! Ne kemi diskutuar edhe më parë në Komisionin e Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik për sa i përket parandalimit dhe raportimit të dhunës në institucionet arsimore. Prej kohësh e kemi ngritur si shqetësim që dhuna nëpër shkolla është një shqetësim që prek më së shumti fëmijët dhe dëmton mirëqenien e tyre. Janë bërë studime të ndryshme nga aktorë të ndryshëm në Shqipëri, ku përmendim: i pari raport që është bërë është ai i Bekan-it, në të cilin është konfirmuar që 69% e fëmijëve të përfshirë në këtë studim janë pre e dhunës psikologjike, 59% e tyre kanë përjetuar dhunë fizike dhe 11% kanë përjetuar dhunë seksuale.

Një tjetër raport është Raport Com 2016, në të cilin thuhet se 1 në 3 nxënës në Shqipëri është pre e dhunës psikologjike, ndërsa 1 në 5 nxënës është kërcënuar nga mësuesi në frekuenca të ndryshme. Më shumë se 17% e adoleshentëve në arsimin e mesëm e të lartë raportojnë se diskriminohen në bazë të orientimit të tyre seksual. Ky është një raport i bërë nga Ambasada Pink.

Studimi më i fundit është edhe ai i Këshillit të Europës, i cili ka evidentuar që 19,4% e nxënësve janë të përfshirë në fenomenin e bulizmit, 2 deri 3 herë në muaj, 73% të nxënësve viktima parapëlqejnë të raportojnë bulizmin dhe mësuesit e përfshirë po në këtë studim, 86,6 % e tyre e shohin të nevojshme të kenë një mekanizëm ku të raportojnë rastet kur ndodhen fenomenet e abuzimit apo bulizmit nëpër shkolla.

Dua të kthehem te progresraporti i Shqipërisë për vitin 2018. Pavarësisht të gjitha përmirësimeve që ka pasur dhe ka performuar Shqipëria në vitin 2018, kanë bërë rekomandimin që në vitin e ardhshëm Shqipëria duhet të përmirësojë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe të garantojnë barazinë gjinore.

Për t'u lidhur pastaj edhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, ne nuk do të arrijmë kurrë të sigurojmë një arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe me shanse të barabarta për të gjithë, objektivi nr. 4, nëse fëmijët do të jenë pre e dhunës dhe bulizmit. Kjo lidhet gjithashtu edhe me objektivin nr. 16, që ka të bëjë me paqen dhe drejtësinë.

Gjithashtu, ne jemi përfshirë dhe kemi parë ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, i cili autorizon ministrinë përkatëse që të ngrejë mekanizmat efikasë për të mbrojtur fëmijët nga dhuna, pra Ministria e Arsimit është ajo, e cila duhet të vihet në lëvizje për të parë se si është mekanizmi aktual, çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon.

Kohë më parë kemi prezantuar një raport që kemi bërë si koalicion, pasi e kemi konsultuar këtë edhe me urdhrin e psikologut për të parë nëse skema që ne propozojmë në këtë raport mund të jetë efikase. Për të parandaluar, trajtuar dhe raportuar rastin e Shqipërisë dhe shkollave shqiptare, kemi konsultuar edhe dokumentet aktuale që ka Ministria e Arsimit, një udhëzues në të cilin ata bazohen, por që është shumë i vjetër, sepse urdhri i psikologut është bërë në vitin 2013 dhe dokumenti mban titullin “Ministria e Arsimit dhe Shkencës”, ndërkohë që vitet kanë kaluar dhe nuk mund të jetë më ky udhëzues. Nuk është vetëm ky problemi, por ka të bëjë edhe me përmbajtjen e tij, metodologjinë, me ligjin e ri, me urdhrin e psikologut, që duhet të jenë të licencuar, dhe ka të bëjë edhe me si bëhet lidhja e të gjithë aktorëve për ta raportuar.

Aktualisht për rastet e dhunës: nëse një fëmijë raporton rastin e dhunës në shkollë, do të duhet të shkojë ose te psikologu kur ai ndodhet në shkollë, ose te mësuesi kujdestar, ose te drejtori i shkollës. Në fakt, nuk duhet të funksionojë kështu, fëmijët duhet të kenë pikën e tyre fokale ku duhet të adresohen. Në këndvështrimin tonë si koalicion, psikologu ose punonjësi social që është në shkollë, duhet të jetë avokati i fëmijëve në shkollë. Aktualisht, janë 347 psikologë në Shqipëri, bazuar në të dhënat statistikore që kemi marrë nga Ministria e Arsimit. Udhëzimi i ri i zonjës Nikolla, që është bërë gjatë vitit 2018, autorizon se duhet të ketë të paktën 1 psikolog në ato gjimnaze ku ka 700 nxënës. Ne nuk e dimë nëse ky ligj ka hyrë në fuqi dhe nëse është rritur realisht numri i psikologëve. Ne nuk kemi një raport...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është planifikuar, por ne nuk kemi të dhëna, sepse ende...

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

**Altin Hazizaj** – Ky është i muajit prill. Më 03.04.2018 është firmosur nga Ministria e Arsimit. Ne si koalicion kemi ngritur dhe do të vazhdojmë të ngremë problemin që duhet një raport i përgatitur nga Ministria e Arsimit për sa u përket rasteve që janë raportuar në DAR dhe në ZA nga personat përgjegjës për dhunën në shkolla. Si është bërë trajtimi i tyre? Sa raste ka pasur?

**Vasilika Hysi** – Do t’ju bëj një pyetje, sepse këto i keni dëgjuar. Ju keni qenë edhe në komisione.

Për sa i përket planit kombëtar të veprimit, axhenda për fëmijët ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Unë jam informuar nga UNICEF-i, meqenëse është kërkuar edhe një takim me grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, që po bëhet një rishikim i axhendës dhe në mars do ta paraqesim në grupin e deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”. Ata kanë kërkuar angazhimin e Kuvendit për të kontribuar.

A është e mundur t’i përshijmë te axhenda të gjitha këto shqetësime që ju përmendni, pa pasur shumë plane veprimi, sepse axhenda ka plan veprimi?

**Altin Hazizaj** – Axhenda është një dokument shumë voluminoz dhe ky është problemi. Në bindjen tonë, besoj edhe nga vlerësimi që do të bëjë agjencia, edhe me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, ka për të rezultuar që është e vështirë për t’u zbatuar e gjitha dhe është problemi i standardit dhe i shumë strategjive të mëdha që ne si shoqëri civile i kërkojmë. Pra, po të jem kritik, jemi ne që kërkojmë disa gjëra.

Pse po përdorim fjalët “plan veprimi”? Institucionet shpesh kur kanë strategji, mendojnë se u zgjidh çdo gjë, por ndërkohë atyre nuk u atashohet buxheti, që është një shqetësim i zakonshëm, por edhe një plan veprimi specifik, që do të thotë se axhenda ka vetëm një element të vetëm dhe vetëm një herë përmend që pjesë e axhendës është trajtimi për eliminimin e dhunës në shkollë.

Meqenëse preket pothuajse 80% e popullsisë së fëmijëve, në vend që unë të merrem me referencë tek axhenda, që, në fakt, është një politikë publike, nuk është zgjidhje, ne rekomandojmë të dyja ministrinë, Ministrinë e Drejtësisë, por kjo mbetet për t’u diskutuar, sepse ka të bëjë me dhunën që ndodh në institucionet peritenciare, dhe Ministrinë e Brendshme, sepse aty është trafikimi, janë disa çështje specifike dhe grupe specifike.

Çfarë do të bënte plani? Një plan pune për 5 vjet do të tregonte se çfarë do të bëjmë në vitin e parë, në vitin e dytë dhe të tretë. Pra, të hartojmë masa konkrete se çfarë do të bëjmë.

**Milva Ekonomi** – Kur bëtë takim bashkë në komision, ku ju prezantuat studimin tuaj...

**Altin Hazizaj** – Draftstudimin.

**Milva Ekonomi** – Dakord, por ka disa gjëra për të rregulluar.

Draftstudimi ka dy gjëra të rëndësishme edhe për t’i pasur ne si zgjidhje. Natyrisht që shoqëria civile ka një rol shumë të rëndësishëm dhe jep një model, por nuk është e thënë që modeli i përfaqësuar nga disa organizata të zbatohet nga ekzekutivi, sepse ekzekutivi ka edhe prioritete të tjera, tregues, shikon qasjen që ka sipas buxheteve, ndërkohë, atë ditë ne kishim edhe

një zonjë nga Ministria e Arsimit, e cila na shpjegoi që edhe ato bëjnë një raport. Ne nuk duam ta quajmë “dhunë ndaj fëmijëve”, por “bulizëm”, sepse ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta quajmë “dhunë”, që të biem dakord për fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Ajo tha se bënë një raport për një monitorim 6-mujor, nëse nuk e mbaj mend gabim, dhe këtë e kishin si detyrim ta vendosnin në *web*-in e ministrisë. Në kohën kur ne bëmë takimin, ky botim nuk ishte vënë në *web*-in e ministrisë. Ajo e kishte marrë me vete, kishte *hard copy*, por kjo nuk e bënte plotësimin e detyrës dhe nuk bënte akses për publikun.

Këtu ka diçka tjetër që lidhet me metodologjitë. Sido që të jetë, ju i jepni një shtysë që ata ta vendosin. Raporti juaj final do t’u shkojë atyre patjetër, por është mirë të mos ulemi në nivelin tonë, sepse ne e dhamë udhëzimin. Më pas, mbase do të kërkojmë një takim me ekzekutivin e ministrisë, që ata të shikojnë nëse përputhet propozimi juaj me logjikën e tyre, sepse ata e bëjnë, nuk kemi pse t’i japim ne më shumë ngarkesë për këtë gjë. Rasti i dhunës seksuale në Kavajë është ekstrem. Ti duhet marrësh masa për të ndërtuar rastin ekstrem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një nga gjërat e rëndësishme që ju duhet të bëni...

Te *VoxPop*-i që bëri “Top Channel”, ishte një studim, që duhej të ishte i vjetër, i vitit 2012 ose 2013, për mënyrën si e shikonin të rinjtë moshën që ishte ulur për seksin e herës së parë dhe si mendonin ata që çfarë e krijonte dhunën seksuale, ku nuk ndalonte asnjë nga vajzat që të jepnin përgjigjen e pyetjes që bënte gazetarja, dhe ndalonin kryesisht djemtë, dhe mua më bëri përshtypje një djalë, i cili thoshte se është e vërtetë që në Shqipëri ka rënë mosha e seksit për herë të parë, po barazohet me vendet e tjera europiane ose të rajonit. Ka një diferencë shumë të madhe mes nesh dhe rajonit, sepse edhe në Itali, Greqi dhe Kosovë mund të qëllojë që dikush kur bën seks për herë të parë, të filmohet nga partneri ose partnerja dhe t’i thotë që mund t’i hidhen videot në rrjetet sociale, por menjëherë ai që kërcënohet i thotë: mua nuk më bën asgjë, sepse ti ke bërë një krim.

A kanë ndjeshmëri fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë për këtë ngjarje, për këtë krim? Unë kam shumë pyetje për këtë gjë, sepse lidhet me edukimin, edukatën seksuale, posterat e të tjerë, siç është bërë atëherë për të drejtat e fëmijëve, që ia printonin. Duhet bërë disa gjëra, sepse situata ka ndryshuar shumë. A i jemi përgjigjur ne kësaj sate? A kemi bërë një ekstrakurikul

për këtë gjë? Unë nuk e di, duhet diskutuar me ministrinë kjo pjesë, por është diçka që duhet bërë, se e pamë në realitet çfarë ndodhi.

**Altin Hazizaj** – Unë them që kur ndodhin raste të tilla, na ndihmojmë të kuptojmë se ku janë pikat e dobëta. Në aspektin institucional ka vlerë për ju dhe për ne, sepse tregon se, pavarësisht të gjitha të mirave që përpiqet të bëjë shoqëria civile, ka mangësi edhe në punën tonë. Jo më kot kemi dërguar një dokument, i cili nuk është shterues, por adreson disa nga shqetësimet kryesore.

Për të kaluar te plani, dhe ta lidh me ministrinë...

**Vasilika Hysi** – Më fal që po të ndërhyj, por duhet ta mbyllim, sepse kam një takim. Milvën e kam kthyer nga rruga, sepse ishte nisur për në Durrës.

Nëse ne sugjerojmë që në kuadër të rishikimit të axhendës, ajo të shoqërohet me një planveprimi afatmesëm 2-5 vjet, që mos të kemi plane pa fund, a mund të bëhet kjo? Ne mund ta adresojmë menjëherë.

E para, për kodin e sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve, unë kam parë të drejtat e fëmijëve në shkolla. A është diçka ekstra nga kjo që tha kolegja Ekonomi, që janë 10 pikat e të drejtave të fëmijëve dhe kush duhet ta bëjë?

**Altin Hazizaj** – Ky është një kod sjellje që i bashkëngjitet çdo kontrate kolektive ose individuale të personave që janë në kontakt me fëmijët. Pra, një mësues, kur firmos kodin e sjelljes, që i bashkëngjitet kontratës kolektive të mësuesve, automatikisht në atë kontratë, për të cilën ai merr një kopje, i caktohen rregullat bazë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është gati, sepse është ndërkombëtare.

Caktohen rregullat bazë çfarë lejohet ose nuk lejohet kur je në kontakt me fëmijët dhe, nëse ka një incident me fëmijën, nëse ti dyshon ose e ke vërtetuar që ka ndodhur diçka me të, kujt duhet t'i raportosh. Kaq zgjidh kodi. Pra, mundohet të krijojë një sjellje të re për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Për sa u përket protokolleve të rastit, në dijeninë time, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale ka bërë protokolle. Sapo mora shqetësimin tuaj, unë kam gjetur një material shumë të mirë të vitit 2013 të botuar në shqip nga OSBE-ja. PNUD-i kishte bërë protokolle, Policia e Shtetit kishte protokolle, madje edhe për LGBT-të, për të gjitha veprimet që bëhet me

një viktimë, kur mbërrin në polici, pyetjet e të tjera. Unë isha dje në prezantimin që bëri Komiteti i Helsinkit të Holandës dhe manuali ishte miratuar vjet që tregon ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kanë bërë me Këshillin e Europës, po është ai projekt. Përderisa kemi kaq shumë manuale, janë protokollet dhe udhërrëfyesit, na mbetet të bëjmë vetëm një kërkesë me shkrim, marrje informacioni, që të na japin një kopje protokollit për ta bërë vlerësimin. Secili nga ne deputetët këtu mund të bëjë një kërkesë për marrjen e informacionit nga ministria bazuar në shqetësimin tuaj. Biem dakord me këtë?

**Altin Hazizaj** –A mund të bëj një koment?

Në bindjen tonë, qofsha unë i gabuar, e marr përsipër të gjithë përgjegjësinë shoqërore në këtë aspekt, unë nuk di që Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë...

**Vasilika Hysi** – Në Kodin e Drejtësisë e kemi lënë Ministrinë e Drejtësisë bashkë me Ministrinë e Çështjeve Sociale, sepse Kodi mbronte ...

**Altin Hazizaj** – Nuk ka asnjë protokoll për këtë çështje. Qofsha unë i gabuar, por nuk ka. Policia e Shtetit nuk ka protokoll, por ka një manual për sjelljen e policisë dhe mbrojtjen e personave LGBTI në rastet e gjuhës së urrejtjes. Në atë manual unë kam qenë një ndër ekspertët e grupit të punës, kam trajnuar edhe punonjës të policisë. Është manual shumë i mirë dhe nëse do të merrej nga policia jo vetëm për gjuhën e urrejtjes, jo vetëm për LGBTI, por për çdo person që është viktimë e gjuhës së urrejtjes, do të ishte arritje.

Për sa i përket protokollit të punës, edhe për ta treguar, në rastin e fundit, ngjarja u raportua në shkollë. Po të kishte protokoll, do të kishte vepruar brenda 24-orëshit.

**Vasilika Hysi** – Jam shumë dakord, Altin, por ka raste që ka protokolle dhe nuk njihen ose nuk zbatohen.

Së pari, do t'i kërkojmë një informacion me shkrim Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale nëse ka protokoll për trajtimin e viktimave. Unë jam në dijeni që prokuroria, nëpërmjet kordinatorëve, është për mbështetjen e viktimave. Ne mbështetëm 30 kordinatorë në buxhet. Pra, prokuroritë kanë një kordinator për mbështetjen e viktimave, që po bëhet nga ambasada amerikane, ICITAP-i. Ne i dhamë buxhetin dhe burimet njerëzore. Të shikojmë çfarë protokollelesh kanë, që të mos kemi një mbivendosje dhe të përsërisim gjëra. Nëse ata janë në përgatitje e sipër të protokolleve, sepse protokollet nuk janë të diferencuara, janë në një manual kapitujt e veçantë, dhuna në familje, trafikimi, viktimat e

mundshme të trafikimit, rastet e gjuhës së urrejtjes, LGBTI-të dhe besoj se do të jenë edhe fëmijët dhe minoritetet e tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, këto protokolle nuk i bën ministria.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Patjetër, do të pyesim.

Për sa i përket çështjes ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po.

**Milaim Degnushaj** – Përshëndetje!

Jam Milaim Degnushaj nga “Të gjithë jemi të ndryshëm, por të barabartë”.

Meqenëse jemi te çështja e viktimave të trafikimit, duke qenë plotësisht dakord me ato që u thanë dhe për të mos përsëritur, zonja Hysi, ju jeni dëshmitare e një diskutimi që kemi pasur për problematikën e ndryshimeve dhe të Kodit të Procedurës Penale. Përtej zhvillimeve pozitive për vendosjen ose krijimin e një pakete të drejtash për viktimat, situata në terren vazhdon të jetë e pandryshuar, të paktën për viktimat e trafikimit, për të mos thënë e përkeqësuar, referuar edhe statistikave të rasteve të suksesshme të hetuara dhe të gjykuara. Po t’i referohemi raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, të dhënat për vitin 2018 nuk kanë dalë ende të plota, por kemi një ulje drastike të çështjeve të hetuara të gjykuara, ndërkohë që referuar statistikave të viktimave të referuara për shërbime, nuk ka ndryshuar numri i viktimave. Shqetësimi që kemi ngritur në fillim, kur janë bërë ndryshimet e Kodit të Procedurës ka qenë se kalimi i kompetencës së prokurorive të rretheve i gjen të papërgatitur ata për të hetuar dhe për të qenë në gjendje të administrojnë hetime që kanë të bëjnë me trafikimin, dhe kjo ndodhi.

Ka pasur edhe një ngërç tjetër, që për një vit u bllokuan çështjet e trafikimit dhe me vendimin e Gjykatës së Lartë u kalua dhe kompetenca u vazhdua të aplikohet nga Gjykata e Krimeve të Renda. Ne presim lajmin e mirë, që shumë shpejt të krijohet SPAKU dhe kompetenca për hetimin e trafikimit, kur nuk është krimi i organizuar, të jetë te prokuroritë e rretheve. Sinqerisht jemi në një situatë shumë shqetësuese, të paktën për ne.

Për të ardhur te çështja e krimeve seksuale dhe pornografisë, me veprat e turpshme që ka ndaj fëmijëve, statistikat tregojnë se 50% e rasteve, viktimë e trafikimit janë të miturit nën 18 vjeç, që do të thotë se një vijë e hollë i ndan nga trafikimi këto lloj rastesh. Në Kodin Penal



dispozita është e tillë, që favorizon, ose në kuptimin e elementeve të provueshmërisë, në rastin e fëmijëve, është më e lehtë, sepse nuk ka nevojë për shfaqje vullneti. Kjo është ideja që ne kemi konstatuar nga trajnimet dhe indikatorët. Ne po punojmë dhe bindja jonë është ajo çfarë tregojnë edhe instrumentet ndërkombëtar. Gjithmonë në rastin e viktimave të trafikimit, në rastin e hetimit, gjykimit, mbrojtjes, duhet patjetër një qasje e veçuar specifike. Kur flasim për fëmijët, gjithmonë politikat e qeverisë janë shoqëruar me strategji më vete për trafikimin e të rriturve dhe strategji më vete për trafikimin e fëmijëve.

Për ta mbyllur, problemi i komunikimeve elektronike, *facebook*-u dhe rrjetet e tjera sociale, edhe sipas policisë, është një nga format më të sofistikuar dhe më të përdorura nga trafikantët për rekrutimin e viktimave.

**Vasilika Hysi – Faleminderit, Milhaim!**

Unë do të bëj një sugjerim konkret, sepse i kam lexuar të gjitha raportet dhe jam në dijeni.

Gjithashtu, edhe Kryetari është në dijeni dhe pret një informacion.

E para, shqetësimin që keni ju, me të drejtë, për shkak të ndryshimeve që u bën në Kodin e Procedurës Penale, praktikë jo shqiptare, sepse është bërë nga partnerët ndërkombëtarë, me qëllim që SPAKU të merret me nivelet e larta dhe jo me çfarëdolloj, përndryshe nuk do të jetë efektiv, ne mund ta adresojmë te Prokurorja e Përgjithshme. Unë mund t'i bëj një kërkesë asaj, sepse, në bazë të ligjit të organizimit të ri të prokurorisë, ajo ka të drejtë të lëshojë urdhra dhe udhëzime për unifikim praktikash dhe për këtë vakum, që u krijua edhe për shkak të reformës në drejtësi dhe problematikës për shtjellime që ka shkaktuar reforma në drejtësi, e para.

E dyta, 30 kordinatorët, ne tashmë i kemi miratuar në Kuvend me buxhet, dhe ekspertët amerikanë, si John Utsaj, ju e njihni shumë mirë, po bëjnë trajnime. FBI-ja është e pranishme, ekspertët ndërkombëtarë janë në terren, dhe të gjithë këta janë të fokusuar te viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Mund ta adresojmë edhe këtë shqetësim...

Shkolla e Magjistraturës po bën trajnime. Unë i kam ndjekur në rrjetet sociale dhe temat që keni ju kanë qenë pjesë, por ne mund t'i kërkojmë zyrtarisht në kuadër të së drejtës për informim.

E fundit, sot miratua raportin. Prokurorja e Përgjithshme do të raportojë brenda datës 9 ose 10 prill. Unë jam raportore për raportin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme dhe do të ishte shumë mirë që në raportimin e saj të adresohen një sërë çështjesh që

ju i keni, që do të thotë se me ardhjen e raportit të Prokurorit të Përgjithshëm, që edhe mund të ketë ardhur, pasi nuk jam në dijeni, sapo të lexojmë çështjet që do të adresohen, do t'ua shpërndajmë të gjitha organizatave, dhe juve, për të gjitha shqetësimet që keni, që të krijoni një mendim alternativ dhe të flisni për shqetësimet që ka ngritur CRCA-ja, *Justice for all*, “Të ndryshëm, por të barabartë”, cilat janë masat dhe t'i lënë disa rekomandime në rezolutë. Është hera e parë që Komisioni i Ligjeve i shqyrton shumë më parë në kohë, që të ketë kohë t'i monitorojë gjatë vitit, plus që ata do të raportojnë në seancën plenare. Pra, ndryshe nga herët e tjera, duke filluar nga viti i kaluar, të gjithë drejtuesit e institucioneve kanë raportuar në seancë plenare dhe kjo është arritje shumë e madhe. Ju keni të drejtë të jeni të pranishëm aty, ne kemi të drejtë të bëjmë pyetje-përgjigje dhe mund të bëjmë edhe debat nëse ka kërkesë.

E fundit, do ta adresojmë mundësinë e rekrutimit nëpërmjet rrjeteve *online* në kuadër të komunikimeve elektronike dhe ligjit tjetër.

Milva, besoj se meqë është e fushës, do të na japë diçka për TVSH-në. Ndërkohë ...

**Milva Ekonomi** – Ju kërkon një debat të posaçëm, “Trego ose flas për dhunën”, një ndërgjegjësim që duhet t'u bëjmë adoleshentëve dhe fëmijëve, prindërve, për dhunën, pasojat dhe po ashtu edhe raportimet, si mund të denoncohet. Patjetër që do t'i bëjmë një kërkesë TVSH-së për këtë gjë, mund të marrim një cikël emisionesh në TVSH. Ndërkohë, mund të flasim patjetër me ata për këtë gjë, por mendoj se para se t'i kërkojmë TVSH-së, duhet të biem dakord me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Drejtësisë, sepse këto nuk janë vetëm çështje që duhet të ndërgjegjësosh, por duhet të japësh qartë edhe mesazhin. Mendoj se para se të shkojmë tek TVSH-ja, duhet të ulemi të rregullojmë mesazhet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Patjetër që e ndjek komisioni ynë.

**Vasilika Hysi** – Nuk ka nevojë për aleancë, e bëni vet.

**Milva Ekonomi** – Nëse ju gjykoni që duhet edhe aleanca... Mesazhet mund të zgjidhen edhe pa aleancën. Ne të gjithë jemi kundër dhunës. Mjafton ta vëmë në dijeni aleancën për këto që po bëjmë dhe mesazhet që do të kalojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ne marrim përsipër të komunikojmë me ministrinë dhe të bëjmë këtë gjë.

**Altin Hazizaj** – Komunikimi u ka shkuar të dyja ministrive, edhe ministres Manastirliu dhe ministres Shahini. Janë të vendosura.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kam një sugjerim, një ftesë për deputetët. Meqenëse ju çdo të premte e keni të rekomanduar të shkoni në zonat elektorale, pse të mos ftoni fëmijët adoleshentë për t'i angazhuar në mënyrë aktive në këto çështje?

**Milva Ekonomi** – Këtë gjë doja të thosha. Ti ma solle më parë në vëmendje.

Të gjithë ne deputetët, pavarësisht nga ngjyrat politike që kemi, kemi lidhje me elektoratin.

Për shembull, unë duhet të merrja përsipër diçka, që nuk e çova deri në fund për shkak të festave të Vitit të Ri. Më pas u mora më shumë në universitetin në Durrës, por të bënim programin “Lexo një libër me fëmijët adoleshentë” në zonat që mbulojmë.

Natyrisht, nëse do të kemi diçka që lidhet me dhunën, një fletëpalosje, një material që ne ta shpërndajmë te deputetët tanë, pavarësisht ngjyrave politike, kur shkojnë nëpër zona, le ta bëjnë këtë gjë, sepse kjo është një gjë e rëndësishme, kombëtare dhe do të ishte gjë shumë e mirë. Mendoj se në këtë fazë ka shumë nevojë për takime kapilare me grupe të vogla, sepse ashtu fillon edukimi. Unë i bashkohem propozimit tënd, por e kisha edhe unë, propozimin.

**Vasilika Hysi** – Unë kam eksperimentuar në njësinë ku punoj një temë që bëme për drogat, për të rinjtë. Erdhën dy zëvendësministrat e Punëve të Brendshme, nga shëndeti publik, nga spitali dhe vetë grupet e të rinjve që kishin përvoja. Kjo gjë funksionoi.

Pajtohen me atë që tha zonja Milva, me një grup jo më shumë sesa 35 vetë. Pyetja ime është: a mund të kemi mbështetjen jo vetëm të organizatës suaj, por të gjitha organizatave që t'u themi deputetëve se çfarë materialesh vini në dispozicion? Këtë e kërkuam edhe në mëngjesin e punës që zhvilluam me të gjithë donatorët që mbështesin Kuvendin në rastet e dhunës në familje, që kur flitet për dhunën në familje, ju si organizata të bëni aktivitete në zonat ku ne punojmë dhe nuk ka sens që deputetët të mos jenë në dijeni. Mund të ftohen të gjithë deputetët, sepse nuk është politizim i shoqërisë civile. Ne jemi përfaqësues të atyre zgjedhësve dhe kur ju ngrini një shqetësim, siç po i analizojmë një nga një rekomandimet tuaja, ne mund ta adresojmë në nivel vendor. Por të jemi të gjithë deputetët bashkë. Në çdo zonë elektorale mund të ketë më shumë se një deputet që përfaqëson aty elektoratin. Do të donim materiale me gjuhë të thjeshtë, një faqe, gjysmë faqe, një udhërrëfyes dhe të jeni të pranishëm kur ka grupime që janë të mëdha. Ne kemi shkolla, të rinjtë, ku mund të mbledhim prindërit, fëmijët, përveç

aktiviteteve që bëni në shkollë. Kemi një pjesë të komunitetit që nuk ka fëmijë në shkollë, por që shikojnë fqinjën që dhunohet, nipin apo mbesën që dhunohen.

Siç e tha zonja Milva ne, grupi i deputetëve “Miq të fëmijëve” ta fillojmë në zonat tona. Duke parë një model ku do të jemi: Milaimi, Linda, Altini, Elona, Klaudia e të tjerë, siç po bën kolegu Bushati ose e ka bërë zonja Milva ku ftohen fëmijët në njësi për të lexuar. Vijnë të gjithë fëmijët dhe lexojmë së bashku.

**Altin Hazizaj** - Ne e kemi përmbyllur, ka qenë e përsëritur si ide me tre qarqe, me tre qytete: Pogradec, Gjirokastrë dhe Shkodër. Kemi punuar me tre grupe të rinjsh, duke i trajnuar për të qenë ata protagonistë në përcjelljen e mesazheve kundër trafikimit. Ne i kemi trajnuar, ka mjaftuar vetëm për t'i nxitur që ata të thellohen. Ata e kanë zgjeruar konceptin që ne ia kemi përcjellë dhe janë shndërruar në frymëzim dhe model për të tjerët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për pjesën e trafikimit, ne kemi modulet, kemi materialet, informacionet, fletëpalosjet të gatshme për t'i ndarë me ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Linda Pino** – Si koalicion ne çdo vit organizojmë fushatën e javës globale për arsimin. Këtë vit fillon në muajin prill dhe është: “Arsimi im, të drejtat e mia”. Po ju tregoj një shembull: kemi organizuar një fushatë në vitin 2013 “Të drejta të barabarta, mundësi të barabarta”. Ka qenë fushata në të cilën fokusi kryesor ishte aftësia e kufizuar, fëmijët dhe e drejta e tyre për arsim. Mjaftoi ky aktivitet që kemi zhvilluar, ku ka qenë e pranishme zonja Nikolla për të vënë në lëvizje ministrinë, për të bërë të mundur që çdo fëmijë të kishte një mësues ndihmës. Nisi me një numër shumë të pakët, sepse ishte zero, nga kjo arriti në një numër. Zonja Nikolla, ka thënë: “Falë nismës suaj, kësaj fushate edhe ne u ndërgjegjësuam”. Pra, janë fushata që ndërgjegjësojnë dhe kanë një produkt.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Milva Ekonomi** – ...roli i ri ose roli më i plotë t'ia vëmë emrin si ta mendojmë që ka marrë psikologu në shkollë. Kjo është shumë e rëndësishme. Është një rol i ri dhe është vendi ku fëmija mund të shkojë dhe të tregojë të gjithë shqetësimet që ka.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** - Po kaloj te çështja tjetër, lidhur me shërbimet mbështetëse për viktimat, janë në kuadër të asaj që diskutuam pak më parë. Është e vërtetë se ka probleme, por jam në

dijeni se në kalendarin që kaluam sot në komision, Nënkomisioni për Vetëqeverisjen Vendore që e drejton zoti Fino, bashkë me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut, ku jam unë, por edhe me Nënkomisionin për Barazinë Gjinore, Parandalimin e Dhunës ndaj Grave kemi ftuar edhe Komisionin për Çështjet Sociale. Miratuar kalendarin në komisionin tonë dhe do të bëjmë monitorimin në terren, do të kemi seanca dëgjimore në komision, seanca pune, sepse këto zgjidhin shpesh më shumë probleme. Besoj se do të kemi një raport shumë më të detajuar.

Lidhur me fondin social jam në dijeni se ai është ngritur. Komisioni përgjegjës duhet të monitorojë mënyrën e shpërndarjes së fondit. Unë i kam kërkuar si deputete ministrit të Brendshëm në një shkresë që të përdorin sa më shumë fondet e konfiskuara, të sekuestruara, asetet e krimit, jo vetëm ndërtesat, por edhe paratë. Ka një nënkomision me përfaqësues të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Brendshme e të tjerë, për të ndarë një pjesë të kësaj shume. Sapo të kemi një informacion besoj se do ta ndajmë me ju, por edhe ju nga ana tjetër duhet të mbani kontakte dhe të na informoni për të gjithë ecurinë. Unë do të doja që në komisionet parlamentare, por edhe grupi i deputetëve, të gjithë të informohen, sepse janë pjesëtarë të komisioneve të ndryshme, nëse ia dërgon të gjithë anëtarëve të “Grupit të deputetëve”, ata do t’i dërgojnë te komisionet e tyre. Unë nuk di se çfarë bëhet te komisioni i zonjës Milva, zonja Milva nuk e di se çfarë ka ndodhur sot në komisionin tonë, por duke ua dërguar informacionin të gjithë deputetëve, mjafton një deputet i një komisioni, të jeni të bindur se atë do ta ndajë me anëtarët e tjerë.

Lidhur me sistemin e raportimit është absolutisht e drejtë. Çfarë ndihme do të donit nga Kuvendi? Doja t’ju dëgjoja. “Alo 116” besoj ia arritëm, ky është edhe sukses i rezolutës që kemi miratuar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Për raportimet, kjo lidhet me atë që tha Martini dhe me regjistrin.

Te dhuna ndaj grave kemi një raportim shumë të mirë, raporton në mënyrë sistematike ministrja te Nënkomisioni për Barazinë Gjinore. Zonja Milva meqenëse ndjek objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, në kuadër të objektivit 4/16 me INSTAT-in, mund të na ndihmosh pak të kemi disa të dhëna ekstra. Zonja Milva për këtë është profesioniste.

**Milva Ekonomi** - Për momentin nuk di t’ju them ndonjë informacion më shumë Ajo që mund të marr përsipër është të shikoj sesi funksionon platforma e dhunës ndaj gruas. Të shikojmë nëse ekstrapolohen të dhënat për fëmijët që shoqërojnë nënën në këtë rast dhe nëse

ajo mund të përshtatet për dhunën që ndodh jashtë familjes, pra të shikojmë nëse përshtatet në mjedise të tjera. Më lini pak kohë dhe e verifikoj vetë.

**Alitn Hazizaj** - *Database* e Ministrisë së Shëndetësisë është lidhur me shërbimet shoqërore. Janë dy *database*, njëra ka të bëjë me dhunën në familje dhe *database* më e madhe ka të bëjë me shërbimet shoqërore që japin njësitë që kanë detyrë dhe janë të koordinuara nga ministria. Unë di që vjet kanë pasur testime, duhet ta fusnin në veprim, di se kanë filluar, por se ku është gjendja e dy *database*-ve nuk e kam idenë. Kjo nuk është e lidhur në asnjë moment me Ministrinë e Arsimit.

**Milva Ekonomi** - Unë mund të shtoj vetëm një informacion që te Komisioni i Sigurisë Kombëtare që drejtohet nga zonja Felaj kemi pasur një diskutim lidhur me ndryshimet në Kodin Penal që kishin të bënin me dhunën, kishim edhe përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë që erdhën me një aplikim real të informacionit. *Database*-t tani funksionojnë. Pra, përderisa kanë bërë raportimin, tregon se ato funksionojnë. Unë nuk di sesi funksionon sistemi. Kam parë vetëm të dhënat finale. Duhet të marr një informacion që t'ju them sesi bëhet kjo gjë. Nëse në shkollë për fëmijën ata marrin ID-në apo numrin e amzës mund të ketë një lidhje me të gjithë sistemin. Më lini pak kohë ta shikoj sesi funksionon dhe pastaj flasim përsëri.

**Vasilika Hysi** - Zonja Elena, keni ndonjë gjë?

**Elena Xhina** - Jam e kënaqur që të paktën dolën në pah disa problematika. Më ka rezultuar se nga tryezat e vogla dalin në pah gjërat konkrete dhe hidhen në letër hapat konkretë që do të bëhen. E rëndësishme është që nga nënkomisionet që janë pranë komisionit tonë janë marrë shumë nisma, edhe rezolutat që kemi kaluar apo planet e veprimit janë hapa konkrete për t'u kryer.

Ju falënderoj për të gjitha problematikat që sollët! Është shumë i rëndësishëm dhe shumë i frytshëm bashkëpunimi.

Për ato që thamë: fletëpalosjet, udhërrëfyesit t'u shpërndahen deputetëve, të cilët në zonat e tyre, atje ku kanë kontakte më të shpeshta me grupet e interesit të përhapin informacionin, pasi shpesh vuajmë nga mungesa e tij.

**Vasilika Hysi** – A keni ndonjë gjë: Klaudia, Elona? Nuk keni.

Për ta përfunduar, biem dakord, që sikurse e thamë për një takim në mbledhjen e radhës të Aleancës së Grave depute “Miqte e fëmijëve”, krahas shqyrtimit të raportit do të bëjmë

prezantimin e paketës, por do të doja të vihet në dispozicion edhe opinion i Prokurorisë së Përgjithshme, ta kemi paraprakisht, edhe opinionin e Ministrisë së Brendshme. E para.

E dyta, AKEP-it dhe AMA-s besoj se ne mund t'u bëjmë një letër për t'u kërkuar informacion se në ç'fazë janë dhe cila është qasja e tyre, për t'i paraprirë takimit dhe mund ta paraqesim në mbledhje si një pikë të rendit të ditës së mbledhjes së Aleancës dhe në këtë kuadër Aleanca mund t'i kërkojë shumë mirë, konkretisht me termat të merret komisioni përgjegjës, por nëse do të ketë nevojë për mbështetje nga ana ligjore, nga ana financave e të tjera, përsëri Aleanca e mbështet.

Lidhur me Regjistrin Kombëtar besoj se do të ishte mirë të kishim një gjysmë faqe model për ta paraqitur, sepse do të doja ta ndaja këtë me zonjën Felaj, që është kryetare e Komisionit të Sigurisë, me Komisionin e të Drejtave të Njeriut, por mirë është ta konsultojmë edhe me ministrin e Brendshëm dhe me ministren e Drejtësisë, sepse është përgjegjëse për çështjen e të drejtave të fëmijëve.

Lidhur me politikën besoj se do të biem dakord që të kërkojmë të flasim me drejtoreshën e agjencisë që në axhendë të ketë një plan veprimi. Pra, në radhë të parë, të përfshihemi në rishikimin e axhendës, meqenëse e ka kërkuar edhe UNICEF-i rolin e Kuvendit në rishikimin e axhendës, është kërkesë zyrtare.

E dyta, të kemi një plan veprimi 2-5 vjet. Më mirë të jetë bashkë me buxhetin.

E treta, lidhur me numrin e psikologëve për vlerësimin. Këtu besoj që Milva e ka merak vetë, sepse është nënkryetare dhe është shumë e ndjeshme.

Edhe për protokollin në rastet e dhunës do të marrim një informacion.

Meqenëse do të thërrasim ministren e Drejtësisë në një seancë dëgjimore për zbatimin e Kodit për mbrojtjen e fëmijëve si autorë, viktimë dhe dëshmitarë. Mund të kemi një kombinim shumë të mirë dhe besoj këtë mund ta bëjmë në një seancë dëgjimore të përbashkët. Pothuajse të gjitha aktivitetet ne i kemi bërë, meqenëse ka shumë mbivendosje ose janë të ndërlidhura.

Lidhur me shqetësimin që tha Milaimi, do t'i drejtohem prokurores së Përgjithshme dhe pa prituri raportimin, që ndoshta kur të vijë të raportojë ta ketë këtë informacion.

Për fushatat dhe ciklin e emisioneve pajtohemi absolutisht me atë çka, me të drejtë, tha Milva. Këtë do ta ndjekë Milva vetë, komisioni, por edhe si anëtare e koalicionit "Deputetët dhe miqtë e fëmijëve" dhe besoj se Milva do të na raportojë edhe në komision.

Mos harroni, unë do t'ju jap edhe një sihariq, më në fund seancat do të transmetohen edhe me gjuhën e shenjave. Kemi qenë gjithë këtë periudhë në diskutime me TVSH-në dhe janë bërë gjithë protokollet. Vështirësia që ne po hasim është që nuk kemi përkthyes, sepse ne i kërkojmë të drejtat. Nga ana tjetër, Kuvendi po tenderon për të përshtatur mjediset për njerëzit me aftësi të kufizuar, qoftë sallën e seancave plenare, ku kemi pasur një problem sepse këtu cenohet siguria, kemi problem që nuk preket godina. Nga këto probleme na dështoi tenderi i parë, pasi Garda nuk dha miratimin, sepse ka disa rregulla të sigurisë kombëtare, pasi është e njëjta hyrje ku hyn Kryetari i Kuvendit, delegacionet etj.. Këtë do të shikojmë si do ta zgjidhim.

Lidhur me fushatën ne ramë dakord dhe ju mbështesim fort. Ne duam nga ju materiale. Do ta nisë Milva, do ta nis unë, besoj Elena, por këtë do ta ndaj me të gjithë anëtarët. Ne do të bëjmë një memo ku do ta ndajmë me të gjithë deputetët të maxhorancës dhe opozitës.

Lidhur me databejsin, besoj se Milva do të na e japë informacion, si dhe shpresoj se Milva shumë shpejt do të na jap një plan të detajuar se si do të përputhim planin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm me këto çështje. Do t'ju lutesha për një kërkesë shumë miqësore: sa herë që keni çështje që lidhen me raportimet, ju keni të drejtën të bëni raporte, se ashtu kam bërë edhe unë dhe kolegët e mi, por një pjesë e çështjeve është mirë të na i adresoni edhe ne, se mund të adresohen dhe të zgjidhen disa çështje.

Unë po lexoja kontributin tuaj për ciklin e tretë të raportit dhe shumë nga këto çështjet mund të ishin adresuar në kohë, pa i lenë që ne t'i kishim të përealizuar për në Gjenevë.

Në bazë të rekomandimit të fundit, Kuvendit i është kërkuar një rritje e rolit të parlamentarëve dhe na është kërkuar një opinion, por duke mos pasur gjithë shkëmbimin e informacionit në kohë, edhe ne nuk e kemi pasur atë rolin aktiv, por të jeni të bindur, keni 41 gra deputete, grupi i deputetëve miq me fëmijët është shumë aktiv dhe ky parlament ka kaq shumë zëra nga të gjitha partitë politike, se mund të bëjmë diçka shumë të mirë për të adresuar këto shqetësime, por duhet të kemi një komunikim në kohë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

... po, ne kemi edhe staf, edhe deputetë, patjetër. Secili nënkomision ka fushën e vet, Eglantina në nënkomisionin e vet, unë te komisioni im, i kemi të ndara komisionet për çështjet e administratës publike, janë të ndara, siç është për KLSH-në Komisioni i Financave...

*(Diskutime pa mikrofon)*



Ne kemi kontribuar goxha, por e keqja është se shumë herë Kuvendi bën shumë veprimtari dhe ne nuk kemi bërë aq shumë PR, dhe për shumë shkaqe, sepse është bërë edhe reforma në drejtësi nga Kuvendi, shumë aspekte janë plotësuar, por nga raporti vjetor që do të bëhet tani i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, draftin që kam parë unë, Kuvendi ka pasur një rol shumë të mirë në vitin 2018, por jo gjithmonë qeveria i di, sepse ne kemi pasur mungesën e ministrit të lidhjeve me parlamentin. Tani që e kemi marrim shqetësimet, por edhe adresojmë shqetësimet tuaja në qeveri.

Falemnderit të gjithëve!

Besoj se do të jemi në kontakt shumë shpejt!

**MBYLLET MBLEDHJA**